

PROCESVERBAL NGA KUVENDI I PUNËS I FVK-së **21 Mars 2025, 16:15h**

Në bazë të Statutit të Federatës së Volejbollit të Kosovës, Neni 18, pika 3, Bordi i FVK-së në mbledhjen e mbajtur me 12.03.2025 vendosi të thërret Kuvendin e Rregullt të Punës 2024. Kuvendi do të mbahet me 21 Mars 2025 (ora 16:15h) në Holiday Resort, në Sllatinë të Madhe me këtë:

Rend i ditës

1. Hapja e Kuvendit nga Kryetari i FVK-së
2. Zgjedhja e Organeve të Kuvendit
 - a. zgjedhja e Komisionit verifikues
 - b. zgjedhja e procesmbajtësit
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të ditës
4. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të Kuvendit të Punës dhe zgjedhor 2024
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës 2024
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të auditimit dhe financiar 2024
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Këshillit Mbikqyrës
8. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të aktiviteteve dhe financiar 2025
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të FVK-së
10. Të ndryshme
11. Mbyllja e Kuvendit të Punës 2024

1. Mbledhjen e Kuvendit të Punës e hapi kryetari i FVK-së Bahri Gjinovci i cili i përshendeti delegatët e pranishëm me një fjalë hyrëse duke i falenderuar për bashkëpunimin dhe arritjet e përbashkëta gjatë mandatit të tij të parë.
2. Më pas i njoftoj se në bazë të Rregullores, kryesinë e punës së Kuvendit përveç kryetarit e përbëjnë nënkryetari/ja dhe sekretari i përgjithshëm, pra Emine Ramadani – Reka dhe Valon Nikqi.

Për komision verifikues kryetari propozoj:

Faton Mustafa, Burim Berisha dhe Vlora Berisha. Meqenëse nuk kishte propozime tjera nga delegatet propozimi u hodh në vota dhe u votua unanimisht nga të pranishmit.

Për procesmbajtës kryetari propozoj **Diellzë Bytyçin** dhe pasi që nuk kishte propozime tjera propozimi u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

Më pas komisioni verifikues filloj me konfirmin e delegatëve të pranishëm. Pas numërimit të delegatëve të pranishëm, komisioni verifikues konstaton se në Kuvend janë të pranishëm **33 delegatë**.

3. Pas konstatimit se ekziston kuorumi për vazhdimin e kuvendit kryetari procedon me shqyrtimit të rendit të ditës. Ai tha se kemi patur një kërkesë për plotësim të rendit të ditës, e cila mund edhe të diskutohet në kuvend meqenëse është rëndësishme.
- Kërkesa e KV Feniks në lidhje me ndryshimin e fazës finale të garave në Ligën e Parë të femrave.

Konsideroj se pika e përmendur më lartë kanë ndikim të drejtperdrejt dhe meriten të diskutohen në kuvend dhe pikat e njejta propozoj që të diskutohen pas zgjedhjeve të organave të reja të FVK-së.

Pas hedhjes në votim rendi i ditës me plotësimet e propozuara nga klubet u miratua unanimisht.

4. Sa i përket procesverbalit kryetari Gjinovci theksoj se materiali është dërguar në kohë dhe keni patur mundësi ta shfletoni, nëse keni vërejtje ose diçka është mirë ta paraqitni, nëse jo po e hedhi në votim.
Unanimisht u votua edhe procesverbali i Kuvendit të Punës dhe zgjedhor 2024, për periudhën 01.01.2024-31.08.2024.
5. Të gjithë delegatët kanë pranuar Raportin e Punës me kohë megjithatë kryetari e ftoj sekretarin që në pika të shkurta ta prezantoj para delegatëve. Pas prezantimit nga sekretariraporti u hodh në votim dhe u votua unanimisht, raporti i kompletuar i vitit 2024.

6. Së bashku me dokumentet përcjellëse kryetari tha se keni pranuar edhe raportin e auditimit dhe pasqyrat financiare të paraqitura në detaje, andaj hapi debat dhe ftoj delegatët nëse kanë ndonjë pyetje. Meqenëse nuk kishte pyetje nga delegatët, raporti financiar u hedh në votim dhe u votua unanimisht, raporti i kompletuar i vitit 2024.

7. Edhe raporti i Këshillit Mbikqyrës-KM është dërguar bashkë me materialet tjera. Kryetarine KM e kemi prezent andaj nëse keni pyetje ose diçk rreth raportit hapi debat.

Meqenëse nuk kishte pyetje raporti u votua unanimisht nga delegatët.

8. Me dokumentet përcjellëse kryetari tha se keni pranuar planin e aktiviteteve dhe financiar të vitit 2025, andaj hapi debat dhe ftoj delegatët nëse kanë ndonjë pyetje apo propozim.

- Lorik Ilazi: Nëse është e mundur që në planin e punës dhe financiar të futet edhe turneu për z. Agim Ilazi, i cili ishte një kontribues i madh në volejboll, ku unë dhe KV Drita do të organizojmë turne ndërkombëtar në nderim të jetës dhe veprës së tij.
- Naser Krasniqi: Duhet të gjejmë një hapsirë të organizojmë një turne për veteranët e sportit, i cili do të ishte shumë i mirëseardhur për komunitetin e volejbollit.

Me këtë propozim u hodh në votim Plani i aktiviteteve dhe financiar për vitin 2025, i cili u votua unanimisht.

9. Kryetari, z. Bahri Gjinovci, theksoi se ndryshimet statutare janë realizuar në përputhje me ligjin e ri të sportit, i cili ka hyrë në fuqi vitin e kaluar. Ai shpjegoi se komisioni për akte normative ka punuar në mënyrë të detajuar dhe ka bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme në statut, duke i përshtatur ato me kërkesat dhe dispozitat e ligjit të ri. Për më tepër, z. Gjinovci theksoi se federata është e detyruar të respektojë afatet dhe kërkesat e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), me të cilën kemi një bashkëpunim të ngushtë, për të siguruar zbatimin e plotë dhe korrekt të ligjit dhe rregulloreve përkatëse.

Pas elaborimit të ndryshimeve statutare në përputhje me ligjin e ri, kryetari e hodhi në votim dhe meqenëse nuk kishte pyetje nga delegatët, u aprovuan unanimisht ndryshimet statutare.


10. Në këtë pikë z. Naser Krasniqi – përfaqësues i KV Prishtina 75, mori fjalën duke përgëzuar FVK-në për të gjitha organizimet dhe transformimin e saj, ndërsa kërkoi që gjatë edicionit të ardhshëm të planifikohen që garat të fillojnë më herët, pasi që të luhen ndeshjet në vikend dhe mesjavë është shumë dhe po shkaktohen lëndimet te lojtarët/ët.

Z. Agron Istogu – përfaqësues i KV Skenderaj, përgëzoj federatën për punën dhe angazhimin gjatë viteve të fundit, duke na qëndruar pranë neve si klube dhe gjithë komunitetit të volejbollit.

Ai kërkoi që sporti i volejbollit të promovohet më shumë në media, pasi kjo do të ndihmonte në rritjen e shikueshmërisë dhe sponsorizimeve, duke kontribuar në forcimin e klubeve.

Me përfundimin e pikës së 10 (të fundit), kryetari Gjinovci e mbylli kuvendin e Punës duke i falenderuar delegatët edhe njëherë për bashkëpunim.

Diellzë BYTYÇI
Procesmbajtëse



21 Mars 2025